



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/-L-025

PËR NISMA LEGJISLATIVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR NISMA LEGJISLATIVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat për nismat legjislative.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji përfshin nismën për të propozuar ligje, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, dhe nga më së paku dhjetëmijë (10.000) qytetarë.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Qytetarë** – çdo qytetarë i Republikës së Kosovës me të drejtë vote.

1.2. **Nismë legjislative** – një propozim që ka për qëllim rregullimin e një fushe me ligj apo me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fuqi.

1.3. **Përfaqësuesi i nismës** -qytetari/ët apo organizimet e qytetarëve që marrin pjesë në nismë legjislative, me qëllim të përfaqësimit të tyre para Kuvendit dhe institucioneve përkatëse si dhe para qytetarëve.

Neni 4

Nisma legjislative

1. Të gjitha aktivitetet për paraqitjen e nismës legjislative duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

2. Të gjitha projektligjet të cilat i paraqiten Kuvendit duhet t'i përmbajnë kushtet e parashtrimit të një projektligji të përcaktuara në Rregulloren e punës së Kuvendit nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

3. Të gjitha nismat legjislative duhet t'i përmbahen standardeve për hartimin e legjislacionit të përcaktuara nga Qeveria nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

Neni 5

E drejta e nismës legjislative

1. Nismë legjislative, mund të marrë:

1.1. Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushë veprimtaria e vet;

1.2. deputetët e Kuvendit;

1.3. Qeveria; ose

1.4. më së paku dhjetëmijë (10.000) qytetarë me të drejtë vote.

Neni 6
Refuzimi i nismës legislative

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, refuzon nismën legislative në rastet kur nisma:
 - 1.1. është kundër parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe
 - 1.2. nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuar me këtë ligj.

KREU II
NISMA LEGJISLATIVE NGA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 7
Nisma legislative nga Presidenti

1. Presidenti i Republikës së Kosovës, ka të drejtë për të propozuar nismë legislative nga fushë veprimtaria e tij/saj.
2. Presidenti nismën legislative ia adreson Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Neni 8
Nisma legislative nga deputetët e Kuvendit

Së paku gjashtë (6) deputetë të Kuvendit kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Neni 9
Nisma legislative nga Qeveria

Qeveria e Republikës së Kosovës ka të drejtë të nismës për të propozuar ligje, nga fushë veprimtaria e saj, sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe me Rregullat e Punës së Kuvendit.

KREU III

NISMA LEGJISLATIVE NGA QYTETARËT

Neni 10

E drejta e nismës legislative nga qytetarët

1. Çdo qytetarë mund të iniciojë nismën legislative.
2. Çdo qytetarë gëzon të drejta të barabarta për sa i përket nismës legislative.
3. Ndalohet çdo formë e diskriminimit apo kufizimit për të propozuar ligje në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

KREU IV

PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NISMËN LEGJISLATIVE NGA QYTETARËT

Neni 11

Përfaqësuesi i nismës legislative

1. Çdo nismë legislative duhet të ketë përfaqësuesin.
2. Përfaqësuesi i nismës është pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet përkatëse.

Neni 12

Forma e nismës legislative

1. Qytetari/ët kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje duke:
 - 1.1. hartuar projektligjin; apo
 - 1.2. propozuar Kuvendit hartimin e projektligjit.

Neni 13
Njoftimi i Kuvendit për fillimin e nismës

1. Përfaqësuesi i nismës legjislative, njoftimin për fillimin e nismës e dërgon në njësinë përkatëse për Parashtrë dhe Ankesa në Kuvendin e Kosovës dhe ia ofron Kuvendit informacionin se a do të fillon nisma legjislative për hartimin e një projektligji apo për propozimin e hartimit të një projektligji të caktuar duke dhënë shpjegimet e detajuara në shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë.
2. Njësia përkatëse për Parashtrë dhe Ankesa në Kuvend vërteton pranimin e njoftimit për nismën legjislative.

Neni 14
Afati kohor për mbledhjen e nënshkrimeve

Brenda gjashtë (6) muajve nga data kur përfaqësuesi për nismën legjislative njofton Kuvendin e Kosovës për fillimin e nismës duhet të përfundojë procesin e mbledhjes së nënshkrimeve dhe të dërgohet nisma legjislative në Kuvendin e Kosovës.

Neni 15
Financimi i nismës legjislative

1. Shpenzimet që dalin nga përgatitjet për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën legjislative mbulohen nga përfaqësuesi i nismës.
2. Përfaqësuesi për nismën legjislative njofton Kuvendin e Kosovës për mënyrën e financimit të nismës dhe i bën transparente burimet dhe shumën e financimit.

Neni 16
Lista me nënshkrime nga qytetarët

1. Lista që përfshinë të paktën dhjetëmijë (10.000) nënshkrime, duhet përfshijë:
 - 1.1. formën e nismës legjislative dhe emërtimin e saj;
 - 1.2. emrin dhe mbiemrin;
 - 1.3. numrin personal;
 - 1.4. komunën e lindjes;
 - 1.5. nënshkrimin dhe datën e nënshkrimit.

2. Përfaqësuesi përkuqdeset që në listë qytetarët të nënshkruhen vetëm nga një herë dhe t'i përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Çdo faqe e listës duhet ti përmbajë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 17

Verifikimi i listës

1. Lista që përfshinë të paktën dhjetëmijë (10.000) nënshkrime verifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
2. Në rast të ndonjë mangësie të gjetur në kuptim të nenit 16 të këtij ligji gjatë procesit të verifikimit të listës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e njofton përfaqësuesin e nismës që në afat kohor jo më shumë se tridhjetë (30) ditë të përmirësojë listën e nënshkrimeve.
3. Në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se nisma është në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj, brenda tri (3) ditëve e njofton përfaqësuesin e nismës legjislative.

Neni 18

Dërgimi i nismës në Kuvend

1. Projektligji apo propozimi i hartimit të një projektligji të caktuar së bashku me shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë të nënshkruar nga të paktën dhjetëmijë (10.000) qytetarë i paraqitet Kuvendit nga përfaqësuesi i nismës.
2. Përfaqësuesi i nismës Projektligjin e dorëzon te Kryetari apo Kryesia e Kuvendit, në mënyrë solemne

Neni 19

E drejta e ankesës

Në rast se nisma legjislative e ndërmarr nga qytetarët do të refuzohet nga njësia përkatëse e Kuvendit me arsyetimin që nisma legjislative nuk i përmban kushtet e përcaktuara me këtë ligj, qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente për konteste administrative.

KREU V
SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PROPOZIMIT PËR HARTIMIN E
PROJEKTLIGJIT TË INICUAR NGA QYTETARËT

Neni 20
Shqyrtimi i Projektligjit

1. Në rastin kur nisma legjislative nga qytetaret është në formë të Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për shqyrtimin e tij konform Rregullores së Punës të Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.
2. Kuvendi, Projektligjin ia dërgon Qeverisë për marrjen e opinioneve dhe deklaratave përkatëse.
3. Pas marrjes së opinioneve dhe deklaratave përkatëse nga Qeveria, fillon shqyrtimi i Projektligjit sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.
4. Përfaqësuesi i nismës legjislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në punën e komisioneve përkatëse të Kuvendit.
5. Kryesia e Kuvendit mund të lejoj përfaqësuesin të prezantoj nismën në seance plenare ose cakton një deputetë me propozimin e përfaqësuesit që të bëjë prezantimin e nismës në seancë plenare.

Neni 21
Shqyrtimi i propozimit për hartimin e Projektligjit

1. Në rastin kur nisma legjislative nga qytetaret është në formën e propozimit për hartimin e Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për hartimin e tij konform Rregullores së Punës të Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.
2. Kuvendi, bazuar në propozimin për hartimin e Projektligjit mund të kërkojë nga Qeveria hartimin e Projektligjit përkatës.
3. Qeveria, cakton njërën nga Ministrinë si bartëse për hartimin e Projektligjit.
4. Përfaqësuesi i nismës legjislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në Grupet Punuese përkatëse.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Qeveria ka autoritetin të miratojë udhëzues dhe akte tjera përkatëse me qëllim të zbatimit të këtij ligji.
2. Njësia përkatëse që merret me çështje ligjore e Zyrës së Kryeministrit, sipas nevojës edhe në bashkëpunim me institucionet dhe me shoqërinë civile, ndërmarrin masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 23

Dispozitat e këtij ligji do të vlejné në mënyrë analoge edhe për nismat për amendamentimin e ligjeve.

Neni 24 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-025
6 tetor 2011**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI